



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2020:057752

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06597324

APS.nr.50/2023

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani – kryetar, Afërdita Bytyçi dhe Mentor Bajraktari – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Fitore Batatina, në çështjen penale kundër të akuzuarve D.G., V.L. dhe Rr.S., për shkak të veprës penale, secili veç e veç, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i akuzuari Rr.S. edhe për shkak të veprës penale, Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me ankesën se Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.G., avokat F.L., dhe përgjigjen në ankesë të Prokurorisë Speciale të mbrojtësit të akuzuarit Rr.S., av. F.S., të parashtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.8/21, të datës 07.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

I. APROVOHET e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.G., avokat F.L., ashtu që aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.8/21, i datës 07.09.2023, në pikën I. të dispozitivit të tij, sa i përket veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit D.G., anulohet, dhe kjo pjesë e aktgjykimin kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit D.G., avokat F.L. për gjendjen faktike, shkeljen e ligjit penale dhe vendimit mbi dënimin për pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, konsiderohen jo lëndore.

II. REFUZHET e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Speciale e Republikës së Kosovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, PS.nr.8/21, i datës 07.09.2023, në pikën II. dhe III. të dispozitivit dhe atë në pjesën liruese, për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve V.L. dhe Rr.S., vërtetohet.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti Special, me aktgjykimin, PS.nr.8/21, të datës 07.09.2023, të akuzuarin D.G., konform nenit 364 par.1 të KPPRK-së, e ka shpallur fajtor për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 8 (tetë) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Konform dispozitës së nenit 62 paragrafi 2, nën paragrafi 2.3, të akuzuarit i është caktuar dënimin plotësues, Ndalimi i ushtrimit të funksionit në administratë publike ose në shërbime publike pas mbajtjes së dënimit me burgim.

Është obliguar i akuzuari D.G., që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 1000 (një mijë) €, ndërsa shumë prej 100 (një qind) €, për fondin për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha ti paguaj në afat prej 15 ditësh por jo më gjatë se tre muaj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të ankimuar.

Përfaqësuesit e autorizuar të palëve të dëmtuara C.O., Y.K., K.D., H.H.G. dhe M.E., për realizimin e kërësive pasusore juridike janë udhëzuar në kontest juridiko - civil.

Po me të njëjtin aktgjykim gjykata e shkallës së parë konform nenit 363 paragrafi 1.nën paragrafi 1.3 të KPPRK-së, të akuzuarin V.L., për shkak të veprës penale Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarin Rr.S. për shkak të veprave penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe Privim

i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, i ka liruar nga akuza pasi që nuk është provuar se të njëjtit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Shpenzimet e procedurës penale kanë renë në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që Gjykata e Apelit, t'a aprovoj ankesën si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.8/21, të datës 19.07.2023, në pikën II dhe III. të dispozitivit të tij, ku janë liruar nga aktakuza të akuzuarit V.L. dhe Rr.S., për shkak të veprës penale, secili veç e veç, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i akuzuari Rr.S. edhe për veprën penale, Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, aktgjykimin t'a ndryshoj dhe të akuzuarit ti shpall fajtor për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe ti dënoj sipas dispozitave të KPRK-së, apo lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.
- Mbrojtësi i të akuzuarit D.G., avokat F.L., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, t'a ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë me numër, PS.nr.8/21, të datës 07.09.2023, dhe të mbrojturin e tij, të akuzuarin D.G., t'a liroj nga akuza ose aktgjykimin t'a anuloj dhe çështjen t'a kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesën e Prokurorisë Special të Republikës së Kosovës, ka ushtruar mbrojtësi i të akuzuarit Rr.S., av. F.S., me propozim që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me të mbrojturin e tij të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit me parashtresën, PPA/I.nr.588/2023, të datës 23.11.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar, ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.33/2019 e datës 24.10.2023, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, PS.nr.8/21, e datës 07.09.2023, ashtu që të ndryshohet

aktgjykimi i ankimuar sa i përket pikës II të dispozitivit me të cilën është liruar nga akuza i akuzuari V.L., për shkak të veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe pikës III të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar me të cilin është liruar nga aktakuza i akuzuari Rr.S. për shkak të veprave penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale, Privimi i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, dhe të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen sipas dispozitave të KPRK-së, apo lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, ndërsa ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.G., av. F.L., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit konform nenit 390 par. 1 të KPPRK-së, në të cilën ishin të pranishëm: i akuzuari D.G. dhe mbrojtësi i tij, avokati F.L., i akuzuari V.L. dhe mbrojtësi i tij, av. E.H, i akuzuari Rr.S., dhe mbrojtësi i tij, av.F.S., ndërsa nuk ishte prezent Prokurori i Apelit edhe pse i ftuar në mënyrë të rregullt gjyqësore. Mbrojtësi i të akuzuarit D.G., avokati F.L., pasi bëri elaborimin e pretendimeve të bëra në ankesë deklaroi se mbetet në tërësi pranë ankesës së ushtruar me shkrim, ndërsa i akuzuari D.G., deklaroi se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij. Mbrojtësi i të akuzuarit V.L., av. E.H. ka deklaruar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë sa i përket të mbrojturit të tij nuk përmban shkelje dhe si i tillë në këtë pjesë duhet vërtetuar duke propozuar që ankesa e Prokurorisë Speciale të refuzohet si e pa bazuar. Mbrojtësi i të akuzuarit Rr.S., av. F.S., ka theksuar se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me të mbrojturin e tij është i drejtë dhe profesional dhe i ka propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën e prokurorisë dhe të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me të mbrojturin e tij.

Gjykata e Apelit pasi që ka studiuar aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale, ankesën e mbrojtësit të akuzuarit D.G., avokatit F.L., propozimin e Prokurorisë së Apelit, dhe duke analizuar shkresat e lëndës në këtë çështje penale në vështrim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, gjeti se:

*Ankesa e mbrojtësit të akuzuarit D.G., av. F.L., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale është e bazuar, kurse për pretendime tjera të natyrës faktike, materiale dhe vendimit mbi dënim është jo lëndëore, ndërsa ankesa e Prokurorisë Speciale, nuk është e bazuar.*

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale*

Prokurori në ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar në pikën II dhe III që ka të bëjë me pjesën liruese, është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga se dispozitivi i aktgjykimi është i pa qartë dhe në kundërtënie me vetveten dhe arsyetimin e aktgjykimit. Prokurori konsideron se gjykata në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit si dhe për shkak se gjykata nuk ka paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk ka vlerësuar në mënyrë të veçantë saktësinë e provave ngase përkundër faktit se u ka fal besimin të gjitha provave aktgjykimi bie në kundërshtim me arsyetimin. Aktgjykimi nuk është bazuar në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor ashtu që nuk është vlerësuar çdo provë një nga një e në bazë të vlerësimit të provave të nxjerr përfundime të qarta dhe konkrete lidhur me faktet vendimtare ashtu siç është paraparë në KPPK, por në aktgjykim janë të përshkruara provat ashtu siç kanë qenë në procesverbalet e mbajtura pa u konstatuar se cilave prova gjykata u fali besimin e cilave jo.

Gjykata ka bërë vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, ngase po ta vlerësonte në mënyrë të plotë gjendjen faktike nga provat të cilat janë administruar do të vërtetonte se në veprimet e të akuzuarve V.L. dhe Rr.S., janë manifestuar elementet e veprave penale për të cilat janë akuzuar, ngase nga provat e administruara qartë është vërtetua se i akuzuari V.L., ka keqpërdor detyrën zyrtare sipas kompetencës, ka vepruar në atë mënyrë që në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit për të Huajt, mori vendim për revokimin e lejeve të ligjshme të qëndrimit të të dëmtuarve - shtetasve turk C.O., Y.K., K.D., H.H.G. dhe M.E. dhe në kundërshtim me nenin 44 të të njëjtit ligj për O.K. që ishte në procedurë për marrjen e lejes së qëndrimit, por pa përfunduar procedura me vendim të formës së prerë për O.K. veproj duke marrë vendim për revokimin e lejeve të qëndrimit vetëm duke u bazuar në rekomandimin – kërkesën e të akuzuarit D.G., për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq dhe pa u vërtetuar fare nëse informacionet e AKI-së, i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara me ligj, fare nuk ndërmori ndonjë veprim për të vërtetuar se të dëmtuarit paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, e kështu duke u shkelur të drejtat të dëmtuarve, të drejtën e qëndrimit dhe punë të ligjshme në Kosovë, të dëmtuarve u ka shkaktuar dëm moral dhe material, ndërsa gjykata fare nuk e ka vlerësuar këtë çështje. Se i akuzuari mori vendim të kundërligjshëm për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq vërtetohet nga aktgjykimet të cilat janë administruar pranë trupit gjykues të cilat vendime të plotfuqishme edhe vërtetojnë në mënyrë të pa kontestueshme se asnjëri nga të dëmtuarit nuk ka përbërë rrezik për sigurinë kombëtare të Kosovës. Prokurori shton se të dëmtuarit nuk kanë

paraqitur asnjë rrezik për sigurinë kombëtare e kjo vërtetohet edhe nga fakti se i akuzuari V.L., vendimin për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq e kishte marrë me datë 23.03.2018, ndërsa përkundër faktit se pretendon se të dëmtuarit kanë paraqitur rrezik për sigurinë kombëtare vendimet për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq nuk i ka dorëzuar në DHM deri me datë 28.03.2018.

Prokuroria Speciale konsideron që gjykata ka gabuar gjatë vlerësimit të veprimeve të akuzuarit Rr.S., kjo ngase të gjitha provat që janë administruar pa mëdyshje kanë vërtetuar faktin se i akuzuari Rr.S., ka tejkalar kompetencat zyrtare në atë mënyrë që nxori gjashtë urdhra për dëbim me forcë të gjashtë shtetasve të Republikës së Turqisë, të dëmtuarve C.O., Y.K., K.D., H.H.G. dhe M.E., që kishin leje qëndrimi të ligjshëm dhe O.K., që ishte në procedurë për marrjen e lejes së qëndrimit dhe punës, edhe pse në bazë të nenit 99 par.1 të Ligjit për të Huaj, nuk ishte fare në kompetencë të DHM që drejtonte ai, por në kompetencë të DSHAM, përkundër se i nxori urdhrat për dëbim me forcë, urdhrat i nxori edhe pse nuk ishin përmbushur asnjë nga kushtet për lëshimin e urdhrat për dëbim me forcë nga neni 97 par.1 të njëjtit ligj, po ashtu pa e zbatuar procedurën e paraparë me nenin 97 paragrafi 8 i të njëjtit ligj. Prokurori pretendon se gjykata nuk ka vlerësuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike lidhur me veprimet e të akuzuarit Rr.S., po ashtu është vërtetuar si i njëjti gjatë depërtimit të shtetasve turq, i privoj kundërligjshëm nga liria duke i dëbuar dhe depërtuar me forcë të dëmtuarit pa ekzistuar asnjë bazë ligjore e paraparë me dispozitat e nenit 29 par 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Prokurori shton se gjykata gjatë vlerësimit të të gjitha provave lidhur me të akuzuarit Rr.S. dhe V.L., ka konstatuar një gjendje të paqenë të gabuar dhe jo të plotë, andaj mbi këtë bazë prokurori ka propozuar si më lartë.

*Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit D.G., av. F.L.*

Në ankesë mbrojtësi pretendon se në aktgjykimin e ankimuar ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2, lidhur me nenin 369 pika dhe 360 të KPPK-së. Aktgjykimi është i përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2, nën paragrafi 2.7, lidhur me nenin 369 paragrafi 6 dhe 7 si dhe nenin 360 par.2 të KPPK-së, të cilat shkelje kanë ndikuar në marrjen e një vendimi të drejtë dhe të ligjshëm, ngase gjykata e shkallës së parë nuk i ka paraqitur në mënyrë të qartë arsyet për çdo

pikë të aktgjykimit, në arsyetim të aktgjykimit nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh konsiderohen të vërtetuara apo të pavërtetuara, nuk ka bërë vlerësimin e saktësisë së provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës për të cilën është gjykuar. Arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është tejet kundërthënës në vetvete duke theksuar dhe ngatërruar se kërkesa e drejtorit të AKI-së, herë është urdhër e herë rekomandim, të cilat në esencë përbëjnë terme të ndryshme e të cilat në fakt tregojnë raportin mes personit që jep atë dhe atij që e pranon e që në rastin konkret shpërfaq edhe faktin se sa e ka kuptuar gjykata këtë çështje penalo juridike. Mbrojtësi thekson se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e saj përshkruan deklaratat e dëshmitarëve si dhe provat e tjera të cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor (copy paste) nga procesverbalet që janë numër shumë i madh dhe të gjithave u'a ka falur besimin, (përpos njëjës) por dështon në tërësi të tregoj se çka ka vërtetuar me ato prova dhe çka lidhen ato prova me argumentimin e fajësisë për të mbrojturin e tij. Sa i përket kësaj çështje gjykata në aktgjykimin e saj më tutje thekson se nuk i'a fali besimin (dëshmitarit kryesor) ish Inspektorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë Sh.S., dëshmitar në këtë procedurë (dëshmitarë i prokurorisë) i cili është i vetmi autoritet kushtetues dhe ligjor që ka mandat ta kontrollojë dhe auditon veprimtarinë e AKI-së. I njëjti ka deklaruar se nuk ka gjetur shkelje ligjore nga zyrtarët e AKI-së, në rastin në fjalë dhe lidhur me këtë rast ka hartuar Raport të posaçëm, të cilin ia ka dorëzuar kryeministrit, gjykata nuk e ka pasur as idenë me te vogël se çka është siguria kombëtare, cilat janë format e rrezikimit të saj, kush është personi apo organi kompetent për mbledhjen e informacioneve të tilla dhe kush e merr vendimin dhe në çka mbështetet vendimi i tij/saj. Por gjykata ka konstatuar se ata persona në procedurën e zbatimit të ligjit nuk është provuar se paraqesin rrezikshmëri për sigurinë kombëtare (cilën procedurë, ndoshta gjykata ka menduar në procedurën administrative e që do ta bënte gjykatën penale të duket tërësisht jo kompetente) nëse ka menduar ashtu. Kjo sepse së pari vendimet që janë atakuar në gjykatën administrative janë vendime të Ministrisë dhe Policisë e jo të AKI-së, ngase AKI nuk lëshon vendime me arsyetim që mund të trajtohen nëpër gjykata të rregullta dhe se dyti nëse gjykata ka menduar ashtu atëherë me të vërtetë do të dëshmohej se i kanë munguar njohurit themelore mbi funksionimin e AKI-së.

Gjithashtu këtë bindje e përforcon edhe fakti që thuhet nga gjykata e shkallës së parë se AKI ka qenë e obliguar me ligj ta njoftoj prokurorin dhe drejtorin e policisë. Në këtë rast shtrohet pyetja se këtë konstatim cili nen e parasheh, e për më tepër bën edhe një interpretim tërësisht të

gabuar ku thotë se nuk mundet me pas rrezikim të sigurisë kombëtare pa pasur vepër penale pra lëshohet në interpretim të ligjit të AKI-së, duke konstatuar diçka tjetër prej të gjithë akterëve dhe personave përgjegjës për interpretim të atij ligji, të cilët kanë konstatuar se në rastin konkret personat e dëbuar nuk kane kryer veprime që i nënshtrohen ndjekjes penale, por të njëjtit kanë ushtruar aktivitete të cilat kane përberë rrezik për sigurinë kombëtare, gjegjësisht sipas informacioneve të AKI-së të mbledhura tërësisht në pajtim me nenin 2 paragrafin 2.2 aktivitetet në fjalë, janë cilësuar që cenojnë sigurinë kombëtare të vendit, andaj rrjedhimisht konstatimi i gjykatës së shkalles së parë se Drejtori i AKI-së në procedurën e dëbimit të gashte (6) shtetasve turq, ka bërë shkelje të nenit 25 paragrafi 25.2 të Ligjit të AKI-së, është tërësisht i gabuar dhe i pabazuar e këtë e ka konfirmuar edhe dëshmitari kyç i kësaj çështje, ish inspektori i AKI-së, Sh.S. Mbrojtësi ka shtuar se aktgjykimi i shkallës së parë numëron shkelje të pafundme të dispozitave të procedurës penale, pra i mungon tërësisht arsyetimi juridik dhe logjik sa i përket pjesës dënuese që lidhet me të mbrojturin e tij.

Lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike mbrojtja e të akuzuarit pretendon se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht nga ana e gjykatës duke i trajtuar veprimet e njëjta të të mbrojturit të tij, por duke ju dhënë konotacion (drejtim) tërësisht të gabuar, me konstatimin e saj se drejtori i AKI-së, ka pas për obligim që për dëbimin e shtetasve Turq të njoftoj Presidentin dhe Kryeministrin, gjykata gabimisht ka vlerësuar gjendjen faktike sepse një obligim të tillë nuk e ka Drejtori i AKI - së. Gjykata gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike me konstatimin e saj se deklarata e Sh.S., është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë në këtë çështje penale, në mënyrë që gjykata të ketë mundësi të jap një vlerësim të kësaj natyre atëherë dëshmitarët duhet të dëshmojnë në lidhje me rrethanat e njëjta.

Mbrojtja konsideron se në këtë çështje penale, si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit tërësisht të gabuar të gjendjes së fakteve është shkelur ligji penal në dëm të të mbrojturit të tij, të akuzuarit D.G., nga neni 385 paragrafi 1 nenparagrafi 1.1, 1.2, dhe 1.4 të KPRK-se, ngase nga provat e administruara nuk është vërtetuar se veprimet e të mbrojturit të tij, konsumojnë veprën penale për të cilën është gjykuar, i njëjti nuk është përgjegjës penalisht dhe në këtë rast është zbatuar gabimisht ligji penal, sepse po të aplikohet drejt ligji penal, i mbrojturi i tij në kuptim të nenit 363 të KPRK-së, do të lirohej nga akuza.



Sa i përket vendimit mbi dënim mbrojtësi ka theksuar se duke pasur parasyshë shkeljet e lartë përmendura aktgjykimi i ankimuar nuk mund të qëndroj në asnjë mënyrë prandaj edhe nuk e trajton të njëjtin, andaj nga të cekurat ka propozuar si më lartë.

### *Gjetjet e Gjykatës së Apelit*

#### *Të gjeturat për pretendimet ankimore për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale*

Gjykata e Apelit vlerëson si të bazuara pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit D.G., av. F.L., lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave procedurale, dhe si të tilla i ka vlerësuar edhe sipas detyrës zyrtare dhe ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar përkitazi më pikën I. të dispozitivit për sa i përket veprës penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, ndaj të akuzuarit D.G., është marr në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 1.10 dhe par. 2.7, lidhur me nenin 369 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, për çka aktgjykimi i ankimuar në këtë pjesë u anulua konform nenin 402 të KPPK-së, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kjo Gjykatë vlerëson se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale të cituara më lartë kanë ndikuar në marrjen e një vendimi jo të drejtë dhe të ligjshëm, ngase gjykata e shkallës së parë nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë arsyet për pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar. Në arsyetim të aktgjykimit lidhur me kete pikë nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye konsiderohen të vërtetuara apo të pavërtetuara, gjykata nuk ka bërë vlerësimin e saktë të provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e përgjegjësisë penale për të akuzuarin D.G., si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës për të cilën është gjykuar. Arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar në pikën I. të dispozitivit të tij është tejet kundërthënës në vetvete duke theksuar dhe ngatërruar se kërkesa e drejtorit të AKI-së, a ishte urdhër apo rekomandim, të cilat në esencë përbëjnë terme të ndryshme e të cilat në fakt tregojnë raportin mes personit që jep atë dhe atij që e pranon. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar ka përshkruar deklaratat e dëshmitarëve të dëgjuar në shqyrtim gjyqësor si dhe provat materiale të cilat i ka administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor duke konstatuar se u fal besimin, duke mos sqaruar se çka ka vërtetuar me ato prova si dhe lidhshmërinë e atyre provave me fajësinë e të akuzuarit D.G..

Gjykata shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka theksuar se nuk i ka falë besimin dëshmitarit - ish Inspektorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Intelegjencë, Sh.S. i cili ka dëshmuar në këtë çështje penale si dëshmitarë i prokurorisë, ku i njëjti në seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 05.05.2022, ka deklaruar: *“se gjatë vitit 2018, kamë punuar inspektorë i përgjithshëm në AKI. Detyrat dhe përgjegjësitë e inspektorit të përgjithshëm bazohen në Ligjin për AKI-në të cilat janë inspektimi, auditimi dhe hetimi i ankesave ndaj punonjësve të AKI-së, inspektori i përgjithshëm nuk ka kompetenca operationale dhe AKI pjesa operationale nuk ka obligim ta informoj inspektorin e përgjithshëm për operacionin, këtë e kam marr lajmin fillimisht nga mediat të nesërmen kemi filluar një raport inspektimi-hetimi në rastin në fjalë ku i kam angazhuar edhe dy departamentet respective, kërkesa ka ardh nga zyra e kryeministrit R.H. i cili ka kërkuar sqarim të rrethanave për rastin konkret të cilit ju kemi referuar rasti i dëbimit të 6 shtetasve turq për shkak të rrezikimit të sigurisë kombëtare, mesa më kujtohet hetimi ka zgjat dikun 3 - 4 ditë, ku është punuar intenzivisht deri në orët të vona duke përfshirë edhe vikendet ku janë shikuar dhe vlerësuar të gjitha shkresat duke përfshirë edhe raportet informative të dosjes në fjalë dhe janë intervistuar zyrtarët e AKI - së që kanë ditë ose kanë mund të dinë informata relevante për rastin në fjalë si rezultat kemi përpiluar edhe raportin të cilin ja kemi dorëzuar kryeministrit, sa i përket raportit dhe në bazë të shkresave të dosjes ne kemi ardh në përfundim se nuk ka pas shkelje të Ligjit të AKI-së apo tejkalim të mandatit nga AKI përkundër që kanë qenë disa rekomandime kryesisht të natyrës nëse mundem me thanë organizative, por që të njëjtat nuk kanë përmbajta shkelje të Ligjit të AKI-së.....”*

Në faqen 42 të arsyetimit të aktgjykimit lidhur me këtë dëshmitar gjykata shkallës së parë ka konstatuar se: *“gjykata gjen se dëshmia e këtij dëshmitarit nuk është reale dhe e sinqertë, është në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit të AKI-së, kur potencon detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të AKI-së, kur potencon rrezikshmërinë kombëtare, që është e njohur botërisht se nuk ka rrezikshmëri kombëtare pa pasoja dhe pa vepër penale, andaj gjykata gjen se thëniet e dëshmitarit të lartcekur janë në kundërshtim me vlerësimin e provave dhe me deklaratat e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar në këtë çështje penale”*.

Për kolegjin penal të Gjykatës së Apelit është i pa qartë konstatimi i gjykatës se shkallës së parë *“se është e njohur botërisht se nuk ka rrezikshmëri kombëtare pa pasoja dhe pa vepër penale”*, si dhe është i pa qartë konstatimi se *“thëniet e dëshmitarit janë në kundërshtim me vlerësimin e provave dhe me deklaratat e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar në këtë çështje penale”*, ngase siç rezulton nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar gjykata shkallës së parë nuk e ka ballafaquar

dëshminë e dëshmitarit Sh.S. me deklarata e dëshmitareve tjerë dhe as me prova tjera për të ardhur deri të një konstatim i tillë, për me tepër mos falja e besimit dëshmime apo provave në procedurë penale nga ana e gjykatës duhet të jetë e lidhur me prova konkrete.

Kolegji rikujton se vepra penale e keqpërdorimit të detyrës zyrtare, nga përkufizimi ligjor, sipas nenit 422 paragrafi 1 të KPRK-së, rezulton se kjo vepër penale përbëhet prej këtyre elementeve:

- 1). Kryes i kësaj vepre penale duhet të jetë personi zyrtar;
- 2). Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar;
- 3). Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë të përcaktuara në mënyrë alternative dhe konsistojnë në tejkalimin e kompetencave ose mos përmbushjen e detyrave zyrtare; dhe
- 4). Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me qëllimin e kryesit që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t'i shkel të drejtat e personit tjetër.

Elementet e lartcekura prej 1). deri 3). i përbëjnë elementet objektive të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (ndryshe të ashtuquajtura “*actus reus*”), kurse elementi sipas pikës 4). përbën elementin subjektiv të veprës penale të lartcekur (ndryshe e ashtuquajtura *mens rea*).

Për tu konsideruar se është kryer vepra penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, paragrafi 1 të KPRK-së, duhet që të përmbushen në mënyrë kumulative të gjitha këto elemente të lartcekura, ndërsa tek elementet 2). dhe 3). mjafton që të manifestohet së paku njëri prej elementeve të përcaktuar në mënyrë alternative.

Në rastin konkret, nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedhë se gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye mbi faktet e elementit subjektiv dhe objektiv kur të akuzuarin D.G. e ka shpallur fajtor, rrjedhimisht kjo e bënë aktgjykimin që të jetë marr në shkelje të nenit 384 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të KPPK-së, ku aktgjykimit i mungon arsyetimi e që konsiston për faktet relevante mbi arsyet e të cilave e bëjnë aktgjykimin e marrë në shkelje të dispozitave të procedurës penale e që rrjedhimisht kushtëzojnë anulimin e tij.

Ne këtë kontekst kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë është mjaftuar me përshkrimin e deklaratave të dëshmitareve të dëgjuar në këtë çështje penale duke mos përfillur nenin 360 par.1 dhe 2 të KPPK-së, që kërkon si kusht që gjykata të bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat

e proceduara në shqyrtim gjyqësor. Gjykata detyrohet që me ndergjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet që ti ri procedoj provat dhe të njëjtat ti vlerësoj dhe pasi që ti analizoj të marr vendim në përputhje me dispozitat ligjore.

Pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit D.G., avokat F.L. për gjendjen faktike, shkeljen e ligjit penale dhe vendimit mbi dënimin për pikën I. të dispozitivit të aktgjyimit të ankimuar, mbeten jo lëndore.

-II-

Kolegji gjen se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, siç pretendon në ankesë Prokuroria Speciale sa i përket pikës II. dhe III. të dispozitivit të aktgjyimit të ankimuar, në pjesën liruese, për veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, ndaj të akuzuarve V.L. dhe Rr.S., ngase dispozitivi i aktgjykimi sa i përket pikës II dhe III, është i qartë, i kuptueshëm dhe konkret, në përputhshmëri të plotë edhe me arsyetimin dhe përpilimin e dispozitivit. Në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar, janë dhënë arsyet e duhura mbi të gjitha faktet vendimtare sa i përket pikës II dhe III të dispozitivit të kësaj çështje penale-juridike, duke vepruar konform dispozitave të nenit 369 par.6 dhe 7 të KPPK-së, gjykata e shkallës së parë në këtë pjesë të aktgjyimit, ka paraqitur arsyet për çdo pikë të tij dhe atë si ato faktike dhe ato juridike, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo Gjykatë.

*Pretendimet ankimore të Prokurorisë Speciale përkitazi me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të ligjit penal si dhe gjetjet e kësaj Gjykate.*

Prokuroria Speciale e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pikën II dhe III të dispozitivit të tij, edhe sa i përket vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se nga provat e bashkangjitura në aktakuzë si dhe prezantimi i tyre në shqyrtimin gjyqësor nga ana e Prokurorisë është provuar përtej dyshimit të bazuar mirë, se të akuzuarit V.L. dhe Rr.S., janë kryes të veprës penale, secili veç e veç, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit

zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, i akuzuari Rr.S., edhe i veprës penale, Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së.

Kolegji penal i Gjykatës se Apelit gjen se këto pretendime ankimore të Prokurorit Special nuk qëndrojnë, ngase sipas shkresave të çështjes gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë dhe se në këtë drejtim asnjë fakt nuk ka ngelur në mëdyshje sikur se pa të drejtë pretendohet në ankesën e ushtruar.

Kolegji gjen të pabazuara pretendimet e prokurorisë se i akuzuari V.L. si person zyrtarë, drejtor në DSHAM në MPB, në periudhën kohore prej datë 23.03.2018 dhe deri me dt. 29.03.2018, ka keqpërdor detyrën zyrtare duke mos i përmbushë detyrat zyrtare sipas kompetencës, në atë mënyrë që në kundërshtim me nenin 91 të Ligjit për të Huaj, mori vendim për revokimin e lejeve të ligjshme të qëndrimit të të dëmtuarve-shtetasve turq C.O., Y.K., K.D., H.H.D. dhe M.E., dhe në kundërshtim me nenin 44 të të njëjtit Ligj për O.K., që ishte në procedurë për marrjen e lejes së qëndrimit, pa u përfunduar ajo me vendim të formës së prerë, se veproj vetëm duke u bazuar në rekomandimin e të akuzuarit D.G., për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq dhe pa vërtetuar fare nëse informacionet e AKI-së, plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara me ligj për të vërtetuar se të dëmtuarit paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, se i akuzuari V.L., përgjegjësitë e tij ligjore për identifikimin e të dëbuarve, sigurimin e fletudhëtimeve, sigurimin e kujdesit mjekësor dhe autoritetin për zbatimin e operacionit të dëbimit me forcë të tyre, i'a kishte kaluar AKI-së dhe Policisë së Kosovës, në këtë mënyrë duke u shkelur të drejtat e të dëmtuarve, të drejtën e qëndrimit dhe të punës së ligjshme në Kosovë të dëmtuarve u ka shkaktuar dëm moral dhe material.

Kolegji vëren se i akuzuari V.L. ka ndërmarr veprime duke u bazuar në shkresat e AKI-së, të deponua pranë MPB, ku rekomandoi revokimin e lejeve të qëndrimit, për shtetasit turq C.O., Y.K., K.D., H.H.D. dhe M.E., dhe mosdhënien e lejes për O.K., për arsyeje se kinse ata paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, fakt që nuk është provuar fare në procedurë të zbatuar në bazë të ligjit, kolegji po ashtu vëren se pasi që i akuzuari V.L. është ftuar në zyrën e ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, F.S., i cili në intervistë nga Komisioni Hetimor Parlamentar, ka deklaruar se me datën 22.03.2018, ka pranuar një dokument të klasifikuar nga AKI-ja, ka qenë dokument i tillë i rëndësishëm sepse flet për sigurinë kombëtare edhe në atë moment e ka thirr në zyre drejtorin të akuzuarin V.L. të DSHAM dhe sekretarin e MPB-së, i cili në konsekuencë kishte të bënte menjëherë me zbatimin dhe implementimin e kërkesës së tillë, të gjithë personat

e verifikuar që kishin të drejtë edhe ta shohin këtë dokument, ku të njëjtën kohë e ka telefonuar edhe drejtorin e AKI-së, në atë kohë të akuzuarin D.G. për me i tregua që e ka pranuar dokumentin dhe me pyet se a ka të drejtë të procedoj ashtu siç është e paraparë nga ligji, stafit i cili ka qenë aty i akuzuari V.L. i ka dorëzuar dokumentin si dhe ka kërkuar nga ata që të procedojnë në bazë të ligjit, ku ky deklaram gjen mbështetje në deklaratën e dëshmitarit Sh.M. të dhënë pranë Komisioni Hetimor Parlamentar, ku ka deklaruar se drejtori V.L., i ka prezantuar një shkresë që ministri e ka pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe u kishte thënë që kërkesën e analizuam bashkë me Ministrin e Brendshëm, zoti S., edhe me sekretarin e përgjithshëm L.E., në kabinet poshtë dhe në analizat e shkresës dhe nga përmbajtja e shkresës kanë konstatuar *dhe është kërkuar që menjëherë sot të zbatohet neni 6 i Ligjit për të huajt pra të revokohen lejet e qëndrimit për pesë personat për të cilët AKI-ja, ka kërkuar me shkresë.*

Nga dëshmia e dëshmitarit Sh.M. rezulton se në ditën e njëjtë duke vepruar sipas udhëzimeve të marra nga i akuzuari V.L., që kjo punë duhet të kryhet sot si porosi nga kabineti i ministrit, me datë 23.03.2018, bashkë me zyrtarin Q.S. kanë shkruar për të përgatitë vendimet, vendimet ishin në formë të standardeve, veç emrat e mbiemra jepen detale, i kanë marrë vendimet së bashku i kanë përgatitë pesë vendime, për secilin vendim e ka pasë edhe nga një vërtetim për pranimin e vendimit dhe të njëjtat i ka nënshkruar për procedim të mëtejme pranë DMH. Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës se shkallës së parë se në rastin konkret i akuzuari V.L. vetëm ka zbatuar autorizimet ligjore që dalin nga përgjegjësitë dhe detyrat e tij dhe ka përmbushur kërkesat e organeve sipas hierarkisë të kabinetit të ministrit, pasi që vlerësojnë se kontrollet e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhën me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, është trajtuar nga ana e zyrtarëve përgjegjës se kjo shkresë - kërkesë e AKI-së, është konsideruar si e bazuar dhe të njëjtit në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre zyrtare kanë vepruar konform legjislacionit në fuqi, Nenin 6 Ligji nr. 04/l-219 për të Huajt, Refuzimi apo revokimi i leje qëndrimit për rrethanat të sigurisë shtetërore, 1. Kontrollet e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (në tekstin e mëtejme AKI), siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit mbi Agjencinë Kosovare të Inteligjencës. 2. Në raste të refuzimit apo revokimit të leje qëndrimit të të huajit për arsye që ndërlidhen me sigurinë shtetërore, lëshohet vendim pa arsyetim lidhur me rrethanat për të cilat është nxjerrë ky vendim.

Kolegji pajtohet me gjetjet e gjykatës se shkallës së parë se duke u bazuar në shkresën e AKI-së, i akuzuari V.L. konform nenit 6 të Ligjit, nr. 04/l-219 për të Huajt, mori vendim dhe ka revokuar

lejet e qëndrimit për pesë (5) shtetas turq, C.O., Y.K., K.D., H.H.D. dhe M.E., ndërsa për shtetasin Turk O.K., që ishte në procedurë për vazhdimin e leje qëndrimit, AKI kishte dhënë një vlerësim negativ të sigurisë, pasi që këta shtetas turq janë konsideruar se përbëjnë kërcënim për rendin publik dhe sigurinë kombëtare.

Pretendimet e Prokurorisë se i akuzuari V.L. veproj vetëm duke u bazuar në rekomandimin e të akuzuarit D.G., për revokimin e lejeve të qëndrimit për shtetasit turq dhe pa vërtetuar fare nëse informacionet e AKI-së, i plotësojnë kriteret ligjore të përcaktuara me ligj për të vërtetuar se shtetasit turq paraqesin rrezik për sigurinë kombëtare, kolegji i gjen të pa bazuara, sepse i akuzuari V.L. nuk ka qenë kompetent që ti vlerëson informacionet e AKI-së, pasi që konform dispozitave ligjore kontrollet e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë. Konform dispozitave ligjore në fuqi, AKI është institucioni kompetentë në ndërmarrjen e veprimeve brenda përgjegjësive të tyre për verifikimin apo kontrollet e sigurisë lidhur me shtetasit e huaj. Mbi bazën e vendimeve për revokimin e leje - qëndrimeve, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH) në kuadër të Departamentit të Kufirit për shtetasit turk ka nxjerrë urdhra të largimit me forcë, andaj kolegji gjen se me të drejtë gjykata shkallës së parë ka konstatuar se pas administrimit të të gjithave provave në këtë çështje penale nuk qëndrojnë pretendimet e Prokurorisë se është vërtetuar se i akuzuari V.L. të ketë kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, ngase nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë nuk është vërtetuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, andaj në mungesë të provave më të drejtë edhe është liruar nga akuza si në pikën II të dispozitivit të aktgjyqimit të ankimuar.

Kolegji gjen të pa bazuara pretendimet e Prokurorisë Speciale se i akuzuari Rr.S. ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, se si person zyrtarë, Drejtor i DMH, pranë MPB, me datë 29.03.2018, në Prishtinë, tejkaloi kompetencat zyrtare në atë mënyrë që nxorri gjashtë Urdhra për Dëbim me Forcë, të 6 (gjashtë) shtetasve të Republikës së Turqisë, të dëmtuarve C.O., Y.K., K.D., H.H.D., dhe M.E., që kishin leje qëndrim të ligjshëm qëndrimi dhe pune në Kosovë, dhe O.K. që ishte në procedurën për marrjen e lejes së qëndrimit dhe punës edhe pse, në bazë të nenit 99 par.1 të Ligjit për të Huaj, nuk ishte fare kompetencë e DHM që drejtonte ai, por në kompetencë të DSHAM, ndërsa Urdhrat për dëbim me forcë i nxorri edhe pse nuk ishin përmbushur asnjë nga kushtet për lëshimin e urdhrat për dëbim me forcë nga neni 97 par.1 të të njëjtit ligj, ndërsa dëboi me forcë dhe depërtoi të dëmtuarin H.H.G., në mënyrë të kundërligjshme edhe pse atij nuk i ishte revokuar fare leja e qëndrimit dhe e punës në Kosovë dhe nuk kishte as urdhër për dëbimin e tij, në këtë mënyrë

shkeli rënd të drejtat e të dëmtuarve për qëndrim dhe punësim në Kosovë, më ç'rast iu shkaktoi dëm moral dhe material të dëmtuarve.

Kolegji vëren se duke u nisur nga përshkrimi faktik i veprimeve të akuzuarit Rr.S., i njëjti ka ndërmarr veprime duke nxjerr Urdhër largimi me forcë për të depërtuar 6 shtetasit turq: C.O. i lindur me datë ...; K.D. i lindur me datë ...; H.H.D. i lindur me datë ...; M.E. i lindur me datë ...; Y.K. i lindur me datë ... dhe O.K., se Urdhërat për largim me forcë janë arsyetuar për bazën ligjore nenin 6 dhe neni 99 par 2 Ligji nr. 04/1-219 për të Huajt, se pas marrjes së vendimeve për revokimin e leje qëndrimeve të përkohshme dhe të përhershme për shtetasit turq nga DSHAM, me arsyen se në mbështetje të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-219, për të huaj, bazuar në dëshmitë që posedojmë nga institucionet kompetente të sigurisë, duke konsideruar se janë përmbushur kushtet për revokimin e lejeve për shtetasit turq, më pas vjen faza për lëshimin e Urdhërave për largim me forcë nga DHM. Andaj, në rastin konkret kjo Gjykatë gjen se i akuzuari Rr.S. vetëm ka zbatuar autorizimet ligjore që dalin nga përgjegjësitë dhe detyrat e tij dhe ka përmbushur kërkesat e organeve sipas hierarkisë, pasi që vlerësojnë se sipas neni 6. Kontrollat e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, se shkresa e AKI-së, është konsideruar si e bazuar dhe të njëjtit në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre zyrtare i akuzuari Rr.S. ka vepruar konform legjislacionit në fuqi, nenin 6 dhe neni 99 par. 2 Ligji nr. 04/1-219 për të huajt, në bazë të nenit 99. Procedurat e zbatimit të urdhrat të dëbimit, par.2. Urdhri i dëbimit zbatohet menjëherë, në rast se prania e të huajt përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore, andaj kolegji penal i Gjykatës se Apelit gjen se i akuzuari Rr.S. ka vepruar dhe zbatuar urdhrat e dëbimit konform legjislacionit në fuqi, ku kolegji vëren se në praktikë është aplikuar legjislacioni sekondar për nxjerrje e urdhrave që bie në kompetencë të DMH, ku drejtor ka qenë i akuzuari Rr.S., ka nxjerrë urdhrat në përputhje me autorizimet e tij ligjore, siç parashikohen në nenin 6, dhe 99 të Ligjit për të Huajt, numër 04/1-219, edhe nga Rregullorja (MPB) Nr. 02/2017 "Për Organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës të Policisë së Kosovës" veçanërisht në nenin 16 të kësaj Rregullore, si dhe në përshkrimin e vendit të punës, ku një nga përgjegjësitë kryesore të Drejtorit të Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj *është nënshkrimi i vendimeve për dërgimin e shtetasve të huaj në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, si dhe për largimin e tyre vullnetar dhe me forcë, nga territori i Republikës së Kosovës*, pasi që Urdhrave për Largim me Forcë të datës 29.03.2018, i kanë paraprirë Vendimet e DSHAM të Ministrisë së Punëve të Brendshme-DSHAM, të datës 23.03.2018, për revokimin e lejeve të qëndrimit të përhershëm dhe të



përkohshme të Republikës së Kosovës për shtetasit Turk, me arsyetimin se ata paraqesin rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik, krejt këto në përputhje me nenin 98 të Ligjit për të Huaj par.1, pasi që këto urdhra janë plotësuar nga zyrtarët përkatës pra nga vartësit e të akuzuarit Rr.S. dhe në fund vetëm janë nënshkruar nga i akuzuari Rr.S., pasi që hartimi i këtyre formave apo shabllojeve janë përgatitur nga MPB-ja, sipas obligimit që buron nga nenin 94 para 10 i Ligjit nr. 04/1-219 për të Huaj, dhe janë pjesë e Udhëzimit Administrative, e në rastin konkret kemi të bëjmë me Urdhra që bien në kuadër të fushëveprimit të Drejtorit për Migrim dhe të Huaj, ku lidhur me afatin kohor të ekzekutimit të urdhrat të largimit, DMH kishte vendosur të shfrytëzojë variantin e menjëhershëm të largimit me forcë për shtetasit turk për shkak të vlerësimit të kërcënimit të konstatuar nga AKI, ku urdhrat e largimit kanë përmbajtur këshillat juridike për të drejtën në ankesë krejt këto në përputhje me nenin 98 të Ligjit për të Huaj par.1. Në rastin konkret i akuzuari Rr.S. vetëm ka zbatuar autorizimet ligjore që dalin nga përgjegjësitë dhe detyrat e tij dhe ka përmbushur kërkesat e organeve sipas hierarkisë së eprorit të tij, pasi që vlerësojnë se Kontrollat e sigurisë për të huajt për qëllime të përcaktimit të arsyeve që lidhen me sigurinë shtetërore kryhen nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, se shkresa e AKI-së është konsideruar si e bazuar dhe të njëjtit në ushtrim të detyrave dhe përgjegjësi të tyre zyrtare i akuzuari Rr.S. ka vepruar konform legjislacionit në fuqi, nenin 6 dhe neni 99 par 2 Ligji nr. 04/1-219 për të Huajt, neni 99. Procedurat e zbatimit të urdhrat të dëbimit, par.2. Urdhri i dëbimit zbatohet menjëherë, në rast se prania e të huajit përbën kërcënim për rendin dhe sigurinë shtetërore, andaj kolegji edhe pajtohet me gjetjet e gjykates se shkallës së parë se i akuzuari Rr.S. ka vepruar dhe zbatuar urdhrat konform legjislacioni në fuqi, mbështetur në dëshmin e dëshmitarit Sh.G. i dëgjuar në këtë çështje penale i cili ka deklaruar se me datë 28.03.2018, në zyrën e tij është takuar me Drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Migrim dhe Azil të MPB-së, z. V.L. dhe dy zyrtarët të AKI, emrat e të cilëve nuk i di dhe në Drejtorin e Drejtorisë për Migrim dhe të Huaj, kolonel Rr.S., gjatë këtij takimi z. Krasniqi i ka sjell vendimet për revokimin e leje qëndrimit të shtetasve turk, i cili vendim është thirrur në Ligjin për të Huaj se ata paraqesin kërcënim për sigurimin e Kosovës e të cilat vendime i ka marr Drejtori i DMH, z. Rr.S. për ekzekutim *pasi që është në kompetencë të DMH-së*, ku secila agjenci i ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me Ligjin dhe i vetmi autoritet që ka mandat për të vlerësuar se një shtetas i huaj paraqet rrezik për vendin është AKI, nga kjo dëshmi vërtetohet se këtu ka qenë një komunikim dhe vendim tre shkallësh, vlerësimi i AKI-së nuk ka ardhur të Policia e Kosovës por në MPB, dhe vendimet e MPB-së për revokimin e leje qëndrimit bazohet në nenin 6 në Ligjin për të Huaj, *e atë Urdhrat për largimin me forcë të DMH ka për detyrim ta ekzekutoj menjëherë dhe ta largoj të huajin nga territori i RKS-së, në këtë rast është siguria e shtetit*, dhe ka qenë i

bindur që zyrtarët e kanë zbatuar këtë rregullativë, policia nuk ka rrugë tjetër dhe mos zbatimi i vendimit paraqet veprë penale, i tërë procesi është në pajtim të plotë me ligjin për të huajt, pasi që nëse revokohet leje qëndrimi për rrezikimin e sigurisë kombëtare atëherë duhet të dëbohet menjëherë, pasi që udhëzimi juridik për ankesa nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit. Deklarimi i këtij dëshmitari gjen mbështetje edhe në dëshminë e dëshmitarëve tjerë të dëgjuar në këtë çështje penale, konkretisht të zyrtarëve policor që kanë marrë pjesë në aksionin e dëbimi të shtetaseve turk, ku një zëri kanë deklaruar se mos zbatimi i urdhrave paraqet veprë penale, dhe se po të kishin vepruar ndryshe në raporte me udhërin e eprorit do të kishin kryer veprë penale, e që këtë e ka thënë edhe i akuzuari Rr.S. në mbrojtjen e tij.

Se i akuzuari Rr.S. nuk ka kryer veprën penale, Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, siç pretendon prokurori në aktakuzë dhe në ankesën e ushtruar, gjendjen e tillë faktike gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor. Të pa bazuar kolegji i gjen pretendimet e Prokurorisë Speciale se i akuzuari Rr.S., si person zyrtar, Drejtor i DMH, pranë MPB, gjatë muajit mars 2018 në shkollat “M.A.”, në Gjakovë dhe L.. dhe në shtëpinë në lagjen “M.”, në P., me ndihmën e Policisë së Kosovës, privoj kundërligjshëm nga liria, duke i dëbuar dhe depërtuar me forcë të dëmtuarit e cekur në dispozitivin III. të aktgjykimit të ankimuar, pa ekzistuar asnjë bazë ligjore, të paraparë me dispozitat e nenit 29 par.2 dhe 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 13 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale.

Siç rezulton nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor nga gjykata shkallës së parë, i akuzuari Rr.S. ka nxjerr Urdhër largimi me forcë për të depërtuar 6 shtetasit turq: C.O. i lindur me datë ...; K.D. i lindur me datë 11.12.1981; H.H.D. i lindur me datë ...; M.E. i lindur me datë ...; Y.K. i lindur me datë ... dhe O.K., për shkak se paraprakisht të njëjtëve nga ana e DSHAM-it, u janë revokuar leje qëndrimet, nga momenti i revokimit të leje qëndrimit, shtetasit turq janë konsideruar se qëndrojnë jashtëligjshëm në Kosovë. Gjykata ka bërë vlerësimin e veprimeve të akuzuarit Rr.S. si më lartë, po ashtu gjykata ka vlerësuar Njoftimin e datës 05.04.2018, ku i akuzuari Rr.S. i ka dërguar Sh.G. përkatësisht Memorandumin zyrtar lidhur me depërtimin e shtetasit turk me emrin H.H.D. ku vërtetohet se me datë 29.03.2018 në ora 06:30 në zyrën e tij ku prezent kanë qenë edhe toger H.R., udhëheqës i grupit për intervenim në Gj. dhe Reshtër, I.M. si dhe dy zyrtarë të AKI-së, ku gjatë këtij takimi të dy grupeve sipas tij u janë dhënë dokumentacioni përkatësisht vendimet e DASHAM-it, për revokim të leje qëndrimeve si dhe Urdhrat për largimin me forcë si dhe fotografitë kopje me të dhënat veç e veç për 6 shtetasit e

huaj, ku në një rën nga fotografitë kopje letër ishin fotot e shtetasit siç shkruante H.H.D. me datë të lindjes 10.05.1976, dhe njëra fotografi ishte e qartë ndërsa tjetra e errët dhe më e pa qartë dhe janë dukur sikur janë dy persona të ndryshëm me të njëjtat të dhëna, nga e njëjta po ashtu konstatohet se zyrtarët e AKI-së kanë dhënë përgjigjen “*nuk jemi të sigurt edhe ne, mirëpo cili të takohet nga këta të dy sipas fotografive të ndalohet dhe të dërgohet në aeroport*”, gjithashtu gjykata ka vlerësuar edhe raportin e togerit H.R., udhëheqës i Grupit për intervenim në Gjakovë, se si ka ardhur deri të ndalimi, dërgimi i shtetasve të huaj për në Aeroportin e Prishtinës dhe depërtimi i tyre, po ashtu në të njëjtin konstatohet se sa i përket shtetasit me emrin H.H.D. i lindur me datë ..., me të dhënat që posedonin policia, gjatë kalimit përmes terminalit VIP, i njëjti i ka njoftuar se ai është H.H.G. dhe nuk është H.H.D., ku ky njoftim është bërë ende pa kaluar pikën kufitare, për të cilën situatë ka qenë prezent edhe koloneli Rr.S., i cili fillimisht ka kërkuar që i njëjti të vendoset në zyre të veçantë deri sa të bëhet identifikimi i tij. Kolegji vëren se togeri H.R. ka kontaktuar me zyrtarët e AKI-së, të cilët kanë qëndruar në veturën e tyre zyrtare dhe ju ka thënë se ekziston dyshimi se ky shtetas i ka të dhënat e gabuara dhe nuk është ai që kërkohej, ku pastaj zyrtari i AKI-së, nga vetura ka kontaktuar përmes telefonit të tij me njërin nga eprorët e vet dhe pastaj e kanë informuar se pa marrë parasysh këtë ky shtetas duhet të depërtohet njësoj sikurse të tjerët, i akuzuari Rr.S. është informuar se edhe ky shtetas duhet të depërtohet me kërkesën e AKI-së. Gjykata shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se depërtimi i H.H.G. është bërë duke u bazuar në verifikimin e identitetit të dhënave nga AKI-së, e jo nga i akuzuari Rr.S., andaj në rastin konkret i akuzuari Rr.S. vetëm ka zbatuar autorizimet ligjore që dalin nga përgjegjësitë dhe detyrat e tij dhe ka përmbushur kërkesat e organeve sipas hierarkisë së eprorit të tij Sh.G. Prandaj edhe është i drejtë përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se pas administrimit të gjithave provave në këtë çështje penale nuk është vërtetuar se i akuzuari Rr.S. ka kryer veprën penale që ngarkohet në aktakuzë, andaj në mungesë të provave i njëjti edhe është liruar nga akuza.

Pra, përfundimisht kolegji pajtohet me përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se nga të gjitha provat e administruara personale dhe materiale nuk është arritur të vërtetohet se i akuzuari V.L., ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, si dhe nuk është vërtetuar se i akuzuari Rr.S., ka kryer veprat penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe as veprën penale, Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, pasi që me asnjë provë nuk është provuar se të akuzuarit duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar tejkaluan kompetencat e tyre ose nuk i përmbushen detyrat e tyre zyrtare më qëllim që të përfitojnë dobi për vete apo personin

tjetër apo ti shkaktojnë dëm personit tjetër ose që seriozisht ti shkelin të drejtat e personit tjetër, si dhe nuk u vërtetua se i akuzuari Rr.S. privoi kundërligjshëm nga liria të dëmtuarit e cekur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, ashtu siç pretendon prokuroria në ankesën e ushtruar. Andaj, mbi bazën e vërtetimit të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar edhe ligjin penal kur të akuzuarin V.L. e ka liruar nga akuza për shkak se nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe të akuzuarin Rr.S., e ka liruar nga akuza se nuk është vërtetuar se ka kryer veprat penale, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, dhe Privim i kundërligjshëm i lirisë nga neni 196 par.3 të KPRK-së, pasi që qartazi nga provat e administruara nuk kanë rezultuar si të provuara tiparet e veprave penale të cituar më lartë dhe as që kanë qenë të përshkruara veprimet inkriminuese në dispozitiv që do të përbënin figurën e veprave penale për të cilat janë akuzuar të akuzuarit e lartëcekur, andaj, për rrjedhojë nuk ka mundur të ketë alternativë tjetër të aplikimit të ligjit penal.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 dhe 402 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti Special  
APS.nr.50/2023, me datë 17.09.2024

B.profesionale

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Fitore Batatina

Afërdita Bytyçi

Ferit Osmani

Mentor Bajraktari